



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 66, datë 28.12.2020

**PËR LISTËN PËRFUNDIMTARE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR  
GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, NË VENDIN VAKANT, VAKANCË E  
PARAKOSHME, E SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN  
22.11.2019.**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229, të pikës 2 të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të pikave 68, 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi dëgjoi relatimin e relatorit, znj. Miranda Andoni dhe si e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

**VENDOSI:**

- Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, si më poshtë:
  - Sonila Bejtja 76.83 (shtatëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e tre) pikë
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**ZËVENDËSKRYETARE**

Vitore TUSHA

**ANËTARE**

Arta MARKU

**ANËTARE**

Miranda ANDONI

**ANËTARE**

Fiona PAPAORGJI

**ANËTARE**

Saida DOLLANI

**ANËTARE**

Fatjona MEMÇAJ

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020*

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302